

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK**

---

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK**

Sot më datë 06.11.2024, në Tiranë, shtetasi si më poshtë:

- **Franci Hoxha**, atësia Muharrem, amësia Shefikat, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë rruga “Hamide Dalipi, Nd. 16, Tiranë, lindur më 15.10.1995, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me Letërnjoftim ID nr. personal I510150621, i cili, në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” te ndryshuar, dhe në bazë të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Q.K.B, të ndryshuar, hartoi dhe miratoi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë **“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, sipas parashikimeve si më poshtë vijon:

**NENI I**

**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- 1.1 Emri i shoqërisë është **“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK**, (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

**NENI 2**

**SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën rruga “Kristo Luarasi”, Kulla C, Kati 0, Njësia Administrative nr. 14, Tiranë.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Asambleja e Përgjithshme mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 4**

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1 Objekti i shoqërisë **“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK** do të përfshijë:

Import-export, tregti i automjeteve dhe mjeteve motorrike te ndryshme si edhe pjeseve te kembimit, transport nderkombetar dhe kombetar per vete dhe te trete. Kryerje teçdo aktiviteti tjetër qe lidhet me automjetet, trasnportin e tyre, si dhe dhenien me qera e automjeteve te cdo lloji.

## NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 Lekë (njëqind mijë), i shlyer plotësisht, me para, nga ortaku i Shoqërisë.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 kuote, e ndare si më poshtë vijon:  
**1 kuotë që përbën 100 % të kapitalit, me vlerë të përgjithshme 100.000 Lekë, e shlyer nga ortaku Franci Hoxha;**
- 5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaku themelues.

## NENI 6 TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 6.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 6.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

## **NENI 8**

### **ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## **NENI 9**

### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë me shkrim.
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, dhe ligjin 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike”. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratorët ose nga ortakët në bazë të nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord të vendosin në lidhje me rendin e ditës.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratorët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.

- 9.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, përveçse për sa parashikon neni 9.10 i këtij Akti Themelimi dhe Statuti, për vendime që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, sipas nenit 86 pika 1, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të të paktën 51 % të ortakëve pjesëmarrës (shumica e kualifikuar) në bazë të nenit 87 pika 1, të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, te ndryshuar, për ndryshimin e këtij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

#### NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria “FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK, do të administrohet nga Administratori i cili emërohet për një periudhë prej maksimumi 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme. **Shoqëria “FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK, do të administrohet nga: Z. Franci Hoxha, atësia Muharrem, amësia Shefikat, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë rruga “Hamide Dalipi”, Nd.16, Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me Letërnjoftim ID nr. personal I510150621, i cili do të administrojë shoqërinë “FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK, për 5 vjet, duke filluar nga data 06.11.2024 deri më 05.11.2029.**
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar prej tij.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratorëve të shoqërisë.
- 10.4 Administratorët nuk kanë të drejtë të marrin hua nga Shoqëria ose të lëshojnë garanci, dorëzani, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financime të dhëna nga të tretët.

- 10.5 Administratorët do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

#### **NENI 11**

##### **VITI FINANCIAR**

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 11.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë **“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK**, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor 2024.

#### **NENI 12**

##### **KONTROLI FINANCIAR**

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

#### **NENI 13**

##### **BILANCI VJETOR**

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

#### **NENI 14**

##### **DIVIDENDËT**

- 14.1 Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë.

#### **NENI 15**

##### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 15.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, Administratorëve, likuiduesit, do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**NENI 16**

**GJUHA**

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

**NENI 17**

**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

- 17.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.

**ORTAKËT E SHOQËRISË  
“FAVORIT MOTORS ALBANIA” SHPK,**

**Franci Hoxha**

*Franci Hoxha* 